

UNMIK/RREG/2001/30
29 tetor 2001

RREGULLORJA NR. 2001/30

**PËR THEMELIMIN E BORDIT TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË KOSOVËS SI
DHE TË REGJIMIT TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË ORGANIZATAVE
AFARISTE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Bordit të Raportimit Financiar të Kosovës dhe të një regjimi për raportim financiar të organizatave afariste në Kosovë, duke përfshirë edhe certifikimin e kontabilistëve dhe licencimin e revizorëve,

Shpall sa vijon,

Neni 1
Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

‘Raport vjetor’ do të thotë raport i lëshuar nga organizata afariste për çdo vit i cili përfshin pasqyrat e përgjithshme të kontrolluara të gjendjes financiare së bashku me mendimin e revizionimit lidhur me të.

“Revizion” do të thotë kontrollim i pasqyrave të gjendjes financiare nga një revizor i licencuar bashkë me mendimin me shkrim përkitazi me korrektësinë e pasqyrave të tilla.

“BPK” do të thotë Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës.

‘Organizatë afariste’ do të thotë çdo person a grup personash që merren me tregti duke përfshirë korporatat e themeluara konform Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6 të datës 8 shkurt 2001 mbi Organizatat afariste si dhe organizatat afariste që punojnë me kapital publik ose shoqëror.

‘Zyra e regjistrimit të biznesit’ do të thotë organi qeveritar i autorizuar për regjistrimin e organizatave afariste.

“Autoriteti Qendror Fiskal” do të thotë organi qeveritar i themeluar sipas Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/16 të datës 6 nëntor 1999 mbi Themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal dhe çështje të tjera lidhur me të.

“Autoriteti kompetent qeveritar” do të thotë autoriteti kompetent qeveritar që është përgjegjës për çështje financiare dhe ekonomike në Kosovë.

‘Korporatë’ do të thotë organizatë afariste e themeluar si e tillë në mbështetje të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/6.

“Pasqyrat e përgjithshme financiare” do të thotë pasqyra e bilancit, pasqyra e fitimeve apo e humbjeve, pasqyra e qarkullimit të parave të gatshme, pasqyra e ndryshimeve në kryegjë, shënimet, pasqyrat tjera dhe materialet tjera shpjeguese që identifikohen si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të organizatave afariste.

‘KNPA’ do të thotë Komiteti Ndërkombëtar i Procedurave të Revizionit të FNK-së.

‘SNK’ do të thotë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të shpallura nga KNSK.

‘KNSK’ do të thotë Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit.

‘FNK’ do të thotë Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve.

‘SNR’ do të thotë Standardet Ndërkombëtare të Revizionit të shpallura nga KNPA.

‘Revizor i licencuar’ do të thotë personi i licencuar konform dispozitave të kësaj Rregulloreje për të kryer një revizion.

‘Person’ do të thotë personi fizik ose juridik.

‘Organi përkatës mbikëqurës’ do të thotë organi mbikëqyrës i cili është përgjegjës për zbatimin dhe garantimin e zbatimit të duhur të legjislacionit për një kategori të caktuar të organizatave afariste.

Neni 2

Bordi i Raportimit Financiar të Kosovës

2.1 Me anë të kësaj Rregulloreje themelohet Bordi i Standardeve të Raportimit Financiar të Kosovës (në tekstin e mëtejme ‘BSRFK’).

2.2 PSSP-ja i emëron shtatë anëtarë për të shërbyer në Bord. Prej shtatë anëtarëve, një anëtar do të propozohet nga BPK, ndërsa gjashtë anëtarë do të propozohen nga Autoriteti Qendror Fiskal prej të cilëve pesë do të jenë përfaqësues nga komuniteti afarist i Kosovës, nga profesioni i kontabilitetit dhe i revizionit. Anëtarët nuk mund të mbajnë funksione zgjedhore publike. Bordi për nga duhet të jetë shumetnik.

2.3 Anëtarët e Bordit emërohen për një mandat trevjeçar dhe kanë të drejtë të riemërohen përsëri, por jo më shumë se për dy mandate rresht. Mirëpo, pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, dy nga anëtarët e parë të emëruar do të emërohen me mandat trevjeçar, tre anëtarë me mandat dyvjeçar, ndërsa dy anëtarë me mandat njëvjeçar.

- 2.4 Emërimet e para të anëtarëve të Bordit bëhen brenda afatit prej një muaji nga dita kur kjo rregullore hynë në fuqi.
- 2.5 PSSP sipas gjykimit të tij të lirë mund ta largojë ndonjë anëtar nga Bordi, ndërsa në rast të vdekjes apo dorëheqjes së ndonjë anëtari, PSSP emëron sa më parë që të jetë e mundur një anëtar të ri. Anëtari i emëruar në këtë mënyrë shërben gjatë mandatit të mbetur të anëtarit që zëvendësohet dhe mund të emërohet edhe për një mandat tjetër.
- 2.6 Anëtarët e Bordit e zgjedhin çdo vjet një kryesues nga mesi i tyre.
- 2.7 Çdo anëtar i Bordit merr një honorar për pjesëmarrje në mbledhje dhe i kompenzohen shpenzimet e arsyeshme të bëra gjatë pjesëmarrjes në mbledhje dhe gjatë kryerjes së punëve të Bordit.
- 2.8 Bordi do të ketë një shumë të caktuar që i ndahet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës me të cilën sigurohen honoraret, shpenzimet e arsyeshme si dhe përkrahja përkatëse administrativo-teknike, e cila nuk mund të jetë më e vogël se shuma e ndarë nga buxheti i vitit të mëparshëm.
- 2.9 Bordi themelon një sekretari teknike për për t'i kryer detyrat e tij kryesore.

Neni 3

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit

- 3.1 Bordi është i pavarur në kryerjen e përgjegjësiave dhe detyrave të tij, varësisht nga autoriteti i gjithmbarshëm i PSSP-së. Ai mund të nxjerrë udhëzime administrative apo gjëra të tjera që lidhen me funksionet e tij.
- 3.2 Bordi ka kompetenca për të lidhur kontrata dhe, sipas nevojës, për të nxjerrë udhëzime administrative për kryerjen e funksioneve të veta, duke përfshirë kontratat e punësimit, kontratat e strehimit dhe të dhënies me qira të pajisjeve. Këto kontrata duhet të jenë në pajtim me rregullat e prokurimit dhe me procedurat e organit kompetent qeveritar.
- 3.3 Bordi nxjerr standarde të kontabilitetit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK). Bordi vendos se cilat standarde të SNK-së do të zbatohen, duke marrë parasysh mjedisin afarist në Kosovë.
- 3.4 Bordi nxjerr standarde të revizionit në përputhje SNA-në.
- 3.5 Bordi ia përcjellë PSSP-së sa më parë që të jetë e mundur një kopje të të gjitha standardeve të nxjerra. PSSP mund ta përdorë të drejtën e tij për të anuluar çdo standard të posaçëm të nxjerrë nga Bordi.
- 3.6 Standardet të cilat tanimë janë nxjerrë nga Autoriteti Qendror Fiskal në kohën e themelimit të Bordit do të kenë vlerë të vazhdueshme. Bordi, posa të jetë praktikisht e mundur pas themelimit të tij, sërish nxjerr çfarëdo standardi në emër të tij që më parë është nxjerrë nga Autoriteti Qendror Fiskal, pa i ndryshuar fare ato standarde.

- 3.7 Standardet e kontabilitetit dhe të revizionit të nxjerra nga Bordi botohen dhe shpërndahen në tërë Kosovën në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, kurse në rast të mosmarrëveshjes mbizotëron versioni në anglisht.
- 3.8 Bordi u ofron udhëzime teknike dhe informacione organizatave afariste lidhur me standardet e kontabilitetit dhe të revizionit që nxirren nga ai.
- 3.9 Bordi cakton standardet për aftësimin teknik lidhur me certifikimin e kontabilistëve dhe licencimin e revizorëve.
- 3.10 Bordi ka përgjegjësi për licencimin e revizorëve.
- 3.11 Për një afat kalimtar pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, por jo më vonë se deri më 31 dhjetor 2001, kompetencat për licencimin e revizorëve që i ka Bordi barten mbi Autoritetin Qendror Fiskal.
- 3.11 Proecdurat e Bordit do të përcaktohen me një urdhëresë administrative.

Neni 4

Organizatrat afariste që duhet t'i përgatisin pasqyrat e gjendjes financiare

- 4.1 Organizatat afariste që janë korporata, qoftë me qarkullim vjetor më tepër se 200.000 DM (ose 100.000 euro nga koha kur një valutë e tillë hyn në përdorim në Kosovë), qoftë me pasuri të gjithmbarshme mbi 100.000 DM (apo 50.000 euro nga koha kur një valutë e tillë hyn në përdorim në Kosovë), duhet t'i përgatisin pasqyrat e gjendjes financiare për qëllime të përgjithshme në përputhje me këtë Rregullore.
- 4.2 Ndërrmarjet që punojnë me fonde publike apo shoqërore i përgatisin pasqyrat e gjendjes financiare për qëllime të përgjithshme në përputhje me këtë Rregullore.
- 4.3 Organizatat afariste, në mbështetje të neneve të mësipërm 4.1 ose 4.2, gjatë përgatitjes së pasqyrave të përgjithshme financiare duhet t'i përdorin standardet e kontabilitetit të nxjerra nga Autoriteti Qendror Fiskal apo nga Bordi në përputhje me nein 3.6.
- 4.3 Pavarësisht nga neni 4.3, organizatat afariste mund t'i përgatisin pasqyrat e gjendjes financiare për qëllime të përgjithshme në përputhje me SNK-në.

Neni 5

Organizatrat afariste që i nënshtrohen kontrollimeve financiare

- 5.1 Organizatat afariste që kanë qarkullim vjetor ose pasuri të përgjithshme me vlerë mbi 500.000 DM (ose 250.000 euro nga koha kur një valutë e tillë hyn në përdorim në Kosovë) pasqyrat e gjendjes së tyre financiare për qëllime të përgjithshme do të kontrollohen nga revizorë të licencuar në përputhje me standardet e revizionit në fuqi.
- 5.2 Në fuqi do të jenë standardet e SNK-së në gjuhën angleze të përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe. Në rast të mosmarrëveshjes mbizotëron versioni në anglisht.
- 5.3 Brenda gjashtë muajsh nga përfundimi i vitit financiar:

(a) Korporatat në bazë të nenit 5.1 ia dorëzojnë zyrës së regjistrimit të biznesit pasqyrat e revizionuara financiare për qëllime të përgjithshme;

(b) Ndërmarrjet shoqërore të cilat punojnë me fonde publike ose shoqërore që biejnë në kuadër të nenit 5.1, ia dorëzojnë pasqyrat e gjendjes financiare për qëllime të përgjithshme të parevizionuara organit përkatës mbikëqyrës si dhe Autoritetit Qendror Fiskal;

(c) Korporatat në mbështetje të neni 4.1, por jashtë suazava të nenit 5.1, ia dorëzojnë pasqyrat e gjendjes financiare për qëllime të përgjithshme të parevizionuara zyrës së regjistrimit të biznesit, ndërsa

(ç) Ndërmarrjet afariste shoqërore dhe ato që punojnë me fonde publike a shoqërore që i nënshtrohen kësaj Rregulloreje, por jashtë suazave të nenit 5.1, ia dorëzojnë pasqyrat e gjendjes financiare për qëllime të përgjithshme të parevizionuara organit përkatës mbikëqyrës dhe Autoritetit Qendror Fiskal .

Neni 6

Kualifikimet për kontabilistët e certifikuar

6.1 Vetëm personi i cili është i certifikuar si kontabilist nga ndonjë shoqatë profesionale e kontabilitetit mund të njihet apo të thirret si “kontabilist i certifikuar”.

6.2 Një shoqatë profesionale e kontabilitetit mund të autorizojë një person si kontabilist të autorizuar vetëm nëse ai person i është përmbajtur kritereve të përvojës praktike dhe aftësimit teknik të parashtruar më poshtë në këtë nen.

6.3 Nga kontabilistët e certifikuar kërkohet të kenë tri vjet përvojë praktike në cilësinë e kontabilistit dhe të kenë aftësim teknik. Bordi i cakton standardet e aftësimit dhe të certifikimit që, së paku, duhet të përfshijnë fushat e mëposhtme:

(a) Kontabilitetin financiar, duke përfshirë edhe ciklin e kontabilitetit, sistemet e kontabilitetit si dhe shfrytëzimin e të dhënave të kontabilitetit për të bërë vendime afariste;

(b) Standardet e kontabilitetit të Kosovës;

(c) Parimet e menaxhimit financiar të ndërmarrjeve afariste;

(ç) Parimet e kontrollit dhe të revizionit të brendshëm;

(d) Kontabilitetin e çmimeve dhe të menaxhmentit;

(dh) Njohuritë themelore të teknologjisë informative;

(e) Ligjin komercial, ligjin e punës dhe ligjin tatimor të Kosovës si dhe

(ë) Sjelljen dhe etikën profesionale.

6.4. Bordi sipas rastit mund të modifikojë fushëveprimin e standardeve të aftësimit dhe të certifikimit në bazë të praktikës më të mirë ndërkombëtare.

Neni 7
Licencimi i revizorëve

7.1 Bordi mund t'i licencojë si revizorë personat të cilët:

- (a) Janë kontabilistë të certifikuar;
- (b) Kanë dhënë provimet e certifikimit për revizorë dhe janë autorizuar nga një shoqatë profesionale e revizionit dhe
- (c) I përmbushin standardet më të larta të aftësisë dhe ndershmërisë.

7.2 Provimet e certifikimit për revizorë mbështeten në standardet e pranuar ndërkombëtare dhe mbulojnë lëndët e renditura në nenet prej 6.3 (a) deri në (ë) të kësaj Rregulloreje dhe lëmenjtë plotësues vijues:

- (a) Parimet e avancuara të kontrollit të brendshëm dhe të revizionit dhe
- (b) Teorinë dhe praktikën e revizionit.

7.3 Për një periudhë kalimtare prej 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Bordi mund ta licencojë si revizor një person i cili nuk është kontabilist i certifikuar, por që ka tri vjet përvojë përkatëse në kontabilitet dhe që i kryen me sukses provimet e certifikimit të parapara me nenin 7.2.

7.4 Procedurat e certifikimit dhe të licencimit të revizorëve i nënshtrohen shqyrtimit për çdo tri vjet. Shqyrtimin e bën një kolegji i përbërë nga revizorët e licencuar të shtetëve që i plotësojnë standardet e shkollimit, të provimit dhe të përvojës ngjashëm me ato të parashtruara në këtë nen.

7.5 Bordi mund të licencojë revizorë të huaj për të kryer revizione në Kosovë me kusht që revizorët e tillë të kenë certifikata të vlefshme të punës të lëshuara nga ndonjë shtet që ka standarde të ngjashme të shkollimit, të provimit dhe të përvojës me ato të parashtruara në këtë nen dhe të kenë dëshmuar njohuri të ligjeve komerciale, të punës dhe të ligjeve tatimore të Kosovës. Bordi mund t'i licencojë në mënyrë të ngjashme edhe firmat e huaja të revizionit që i kanë zyret e veta në Kosovë, të cilat i plotësojnë së paku dy nga parimet e kushteve të mësipërme.

7.6 Bordi nxjerr udhëzime administrative të cilat i përcaktojnë procedurat lidhur me:

- (a) Licencimin e revizorëve;
- (b) Licencimin e revizorëve të huaj dhe firmave të huaja të revizionit, të cilat mund t'i përfshijnë kushtet e licencës me të cilat kërkohet që revizorët e huaj apo firmat e huaja të revizionit t'i punësojnë dhe t'i aftësojnë qytetarët për kontabilitet dhe revizion dhe
- (c) Shqyrtimin e revizorëve të licencuar dhe certifikimin e kontabilistëve.

7.7 Kjo Rregullore nuk vlen për revizorët e punësuar të Kombet e Bashkuara apo të organeve të saj duke përfshirë UNMIK-un.

Neni 8
Ekzekutimi

Sanksionet dhe dënimet të cilat mund të vëhen për mosrespektimin e kërkesave të përcaktuara me këtë Rregullore sa i përket revizionimit dhe standardeve të kontabilitetit, licencimit dhe certifikimit, si dhe raportimit financiar do të përcaktohen me një urdhëresë administrative.

Neni 9
Arsyetimi i vendimeve

Në rastet kur një vendim merret konform kësaj Rregulloreje ose instrumenteve ndihmëse të nxjerra në pajtim me këtë Rregullore për të refuzuar ndonjë licencim, ose për të shqiptuar sanksione dhe dënime, vendimi dhe arsyetimet e vendimit i jepen pal(ës)ëve të prekura në formë të shkruar. Pal(ët)ja e prekur duhet të njoftohet se ka të drejtë të kërkojë shqyrtim gjyqësor të atij vendimi në një gjykatë kompetente në Kosovë.

Neni 11
Zbatimi

PSSP mund të lëshojë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 12
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore e shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 29 tetor 2001

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm